

ANALIZA E MUAJIT GUSHT

Nr. ____ prot.

Durrës, më ____ . ____ . 2020

2020

PREFEKTI I QARKUT DURRËS

PËRMBAJTJA

- ❑ Task Forcat dhe Komitetet Rajonale
- ❑ Monitorimi i Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara
- ❑ Zhvillimi Urban
- ❑ Emergjencat Civile
- ❑ Gjendja Civile
- ❑ Sektori Juridik
- ❑ Sektori i Financës dhe i Shërbimeve Mbështetëse

DREJTIMI I TASK-FORCAVE DHE KOMITETEVE

Task-Forca Vendore Antikanabis

- Në zbatim të Planit Kombëtar Kundër Kultivimit të Kanabisit pranë Institucionit të Prefektit ka vazhduar puna e Task-Forcës Vendore “Për realizimin e koordinimit dhe bashkëveprimit efektiv të veprimtarisë së Institucioneve Qëndrore (degët territoriale) në nivel vendor dhe të këtyre Institucioneve me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, për parandalimin goditjen dhe shkatërrimin e kultivimit të kanabisit”, në bazë të së cilës janë kryer detyrat si më poshtë:
- Administrimi dhe monitorimi i plan-veprimeve në kuadër të PKKK për të gjitha Institucionet e përfshira në Task-Forcë;
- Ndjekja e kërkesave dhe problematikave të raportuara nga Institucione të ndryshme.



DREJTIMI I TASK-FORCAVE DHE KOMITETEVE


Task-Forca Vendore Antikanabis

- ❑ Në zbatim të Planit Kombëtar Kundër Kultivimit të Kanabisit pranë Institucionit të Prefektit ka vazhduar puna e Task Forcës Vendore “Për realizimin e koordinimit dhe bashkëveprimit efektiv të veprimtarisë së Institucioneve Qëndrore (degët territoriale) në nivel vendor dhe të këtyre Institucioneve me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, për parandalimin goditjen dhe shkatërrimin e kultivimit të kanabisit”, në bazë të së cilës janë kryer detyrat si më poshtë:
- ❑ **Janë evidentuar 25 raste** të kultivimit të bimeve narkotike gjate kontrollit te ushtruar ne Njesite Administrative Nikel, Cudhi, Fushe Kruje, Ishëm, ne fshatrat Rranxë, Kroi I Madh, Mafsheq, Nikel, Mukje, Likmetaj, Noje, Brret, Barkanesh, Droje, vadardhe, Bura,Bruz Zall, Thumane, Cudhi Zall, Bruz Mal, Halilaj, dhe Zall, Durrës, Xhafzotaj.
- ❑ **Janë proceduar penalisht 5 autorë, nga të cilët 0 janë arrestuar, 0 ndiqet ne gjendje te lire dhe 1 është shpallur në kërkim.** Gjithashtu, janë referuar materialet **për 4 persona** , 2 kryepleq të fshatrave dhe 2 punonjës roje mjedisore në ADZM Durrës për veprën penale “Shpërdorim detyre” të parashikuar nga neni 248 i K.penal për veprën penale “Shperdorim detyre ”, parashikuar nga neni 248, te K. Penal.
- ❑ **Janë gjetur/asgjësuar 655 ambjente publike dhe 5 ambjente private me 13.657 bimë narkotike,** nga të cilat **13.657 bime** janë të mbjella në tokë, **0** fidanë/kubikë dhe **0** dege ne process tharje.

DREJTIMI I TASK-FORCAVE DHE KOMITETEVE

Task-Forca Anti COVID-19

- ❑ Është ndjekur në mënyrë periodike ditore ecuria e situatës epidemiologjike në të gjithë qarkun Durrës, ku shifrat e gjendjes së janë që nga fillimi i pandemisë 1259 me COVID-19 (Durrësi 634, Shijaku 6 dhe Kruja 619).
- ❑ Nisur nga situata e krijuar në bashkinë Krujë dhe Durrës pas shtimit të numrit të infektuarve me COVID-19, janë forcuar masat në fasone, call center, shkolla dhe bar-bufe- restorante, kopshte, cerdhe, si dhe janë njoftuar të gjithë për kujdesin e shtuar, u bë kontrolli i personave dhe familjareve të prekur, të cilët janë urdhëruar të futen në karantinë dhe të zbatojnë të gjitha rregullat.
- ❑ Është ndjekur dhe monitoruar situata në bashkëpunim me strukturat e DVP të qarkut Durres të cilat kanë vazhduar përgjatë gjithë muajit me patrullimet dhe kontrollet në rruge sheshe, lagje dhe plazhe.
- ❑ Nga policia po mbahen nën mbikqyrje personat që kanë rezultuar pozitiv me COVID-19 në të gjithë territorin e qarkut Durrës.



FUNKSIONET E DELEGUARA

Shqyrtimi i Kundravajtjeve Administrative në Fushën e Qarkullimit Rrugor




- ☐ Në lidhje me kundravajtjet administrative, në zbatim të Udhëzimit Nr.687 datë 05.12.2013 “Për mënyrën e evidentimit dhe shqyrtimit të kundravajtjeve administrative, procedurat që ndiqen për masat administrative plotësuese dhe administrimi i gjobave në fushën e qarkullimit rrugor” janë shqyrtuar 6 praktika shkresore të dërguara nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Durrës.
- ☐ Ndër këto: 5 për tejkalim shpejtësie, 1 lejon një drejtuesi pa patentë të drejtojë automjetin.



FUNKSIONET E DELEGUARA

Legalizimi i Dokumentave

- Bazuar në VKM Nr.134 datë 07.03.2003 “Për vërtetimin dhe legalizimin e dokumentave të lëshuara në Republikën e Shqipërisë për përdorim jashtë vendit dhe të dokumentave të huaja për përdorim brenda vendit” janë legalizuar 3047 dokumenta të lëshuara nga organet e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.



KOMPETENCAT VENDORE

Arsimi

Më datë 20 gusht 2020 u inspektuan të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar në Bashkinë Durrës, Krujë dhe Shijak të cilat u shembën si pasojë e dëmtimeve të rënda nga tërmeti i 26 nëntorit 2019. Qëllimi i inspektimit ishte kontrolli për pastrimin e inerteve të godinave të shembuar, fillimi i procesit të rindërtimit të këtyre institucioneve të arsimit parauniversitar dhe kompletimin me bazë materiale të shkollave të rikonstruktura së fundmi në qytetin e Durrësit. Institucionet e arsimit parauniversitar të inspektuara në nivel qarku janë si më poshtë:

➤ **Bashkia Durrës**

- 3 shkolla ka përfunduar tërësisht rikonstrukcioni dhe janë kompletuar me bazë materiale
- 8 shkolla janë shembur tërësisht, pastruar inertet dhe ka filluar procesi i rindërtimit
- 3 shkolla janë shembur tërësisht, pastruar inertet, por nuk ka filluar procesi i rindërtimit



KOMPETENCAT VENDORE

Arsimi

➤ **Bashkia Krujë**

1 shkollë në proces shembje

14 shkolla janë shembur tërësisht, pastruar inertet, por nuk ka filluar procesi i rindërtimit

➤ **Bashkia Shijak**

2 shkolla janë shembur tërësisht, pastruar inertet dhe ka filluar procesi i rindërtimit

☐ **Më datë 31 gusht 2020** u inspektuan të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar në Bashkinë Durrës për kryerjen e dezinfektimit të mjediseve shkollore në prag të fillimit të vitit të ri shkollor 2020-2021. Institucionet shkollore të inspektuara vijnë si më poshtë :

6 shkolla të mesme dezinfektimi është kryer;

7 shkolla sistemi 9-vjecar dezinfektimi është kryer



ZHVILLIMI URBAN

Turizmi

❑ Në drejtim të turizmit të gjitha strukturat që ofrojnë shërbime në drejtim të luftës COVID-19 është bërë vlerësimi dhe zbatimi i të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore, rregullave dhe protokolleve të sigurisë ndaj Covid-19 të dala nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirqënies Sociale si dhe Task Forcës së ngritur për këtë qëllim.

❑ Në drejtim të mbarëvajtjes së sezonit turistik veror është bërë vlerësimi dhe angazhim i Stukturave të Policisë së Shtetit, Policisë Kufitare dhe Migracionit, Policisë Bashkiake në lidhje me rendin dhe sigurinë në tërësi

❑ Gjatë muajit Gusht janë është ndjekur dhe monitoruar hyrje - daljet e shtetasve të huaj dhe vendas në territorin tone nga Pika Kufirit Portit Durrës dhe konkretisht për periudhën 31 Korri-27 Gusht kemi këto të dhëna:

Në Stacionin e Policisë Kufitare Port Durrës, DVKM Durrës janë përpunuar në total **49.825** shtetas (shqiptar dhe të huaj) në hyrje dhe në dalje, gjithashtu gjatë kësaj jave janë evidentuar **20.140** mjete me targa (shqiptare dhe të huaja).

❑ Është garantuar e ofruar shërbimit shëndetësor 24 orë në 24 nga Qendrat Shëndetësore Verore në zonat turistike

❑ Nga ISHSH Durrës në bashkëpunim me AKU janë kryer gjatë muajit gusht **rreth 3277** inspektime në subjekte të ndryshme, inspektime këto të plotësuara në google form.

ZHVILLIMI URBAN

Turizmi

- ❑ Gjatë muajit Gusht është ndjekur dhe monitoruar në mënyrë specifike koordinimi i punës me të gjitha strukturat përgjegjëse si dhe ndjekja dhe monitorimi e të gjithë procedurave që po ndiqen nga Qeveria Shqiptare, Komiteti i Emergjencave Civile në nivel qarku në lidhje me menaxhimin e situatës post tërmetit të 26 Nëntorit të vitit të kaluar në bashkinë Durrës. Është ndjekur ecuria e procesit të shërndarjes së granteve për rindërtim nga tërmeti, ndjekja e procesit të ndërtimit të infrastrukturës si pasojë e tërmetit në të tre Bashkitë.
- ❑ Në Shijak po punohet për akomodimin e 874 famijeve në shtëpi të reja, me të gjithë infrastrukturën e nevojshme për furnizimin me energji dhe ujë të pijshëm, kanalizime, ndriçim e sinjalistikë rrugore, rrjetin e telefonisë e internetit, krahas 6 shkollave të reja.
- ❑ Gjatë muajit Gusht janë ndjekur dhe trajtuar rreth 10 praktika shkresore lidhur me problematikat të ndryshme. Problematika të tjera që janë ndjekur në rrugë shkresore kanë qenë kryesisht në lidhje me çështje që ata kanë të bëjnë ndotje mjedisore, problematikat e shkaktuara nga tërmeti etj. Për të gjitha këto problematika Institucioni i Prefektit i është drejtuar në kohë institucioneve kompetente për dhënie zgjidhje të tyre.

EMERGJENCAT CIVILE

□Institucioni i Prefektit nëpërmjet sektorit të emergjencave ka komunikuar në mënyrë të drejtpërdrejt me të tre Stacionet Zjarrfikëse Durrës, Krujë, Shijak duke koordinuar e menaxhuar situatat e zjarreve në Qark. Koncretisht

1. Bashkia Durrës gjatë muajit Gusht ka bërë 87 ndërhyrje në zjarre, ku kryesisht janë djegur shkurre, bimësi, pishë dhe mbi 700 rrënjë ullinj.
2. Bashkia Shijak ka bërë 38 ndërhyrje në zjarre kryesisht shkurre, pishë dhe 500 rrënjë ullinj.
3. Bashkia Krujë ka bërë 36 ndërhyrje në zjarre kryesisht pyje, shkurre, 400 rrënjë ullinj si dhe djegijen e dy bizneseve 1 për përpunimin e drurit në urën e Gjoles dhe një fason në qytetin e Fushë-Krujës me dëme të konsiderueshme materiale.

□Problematikë tjetër e ndjekur është dhe pastrimi i kanaleve të ujrave të larta nga ndërmarrja ujitjes dhe kullimit ku janë inspektuar kanali T14 me gjatësi 3.5 km Budull-Bilaj që vërtetë ishte bërë një punë e lavdërueshme nga kjo ndërmarrje. U inspektua dhe kanali i Tones në sektorin Koxhas ku dhe këtu ishin pastruar 2 km kanal nga kjo ndërmarrje.

EMERGJENCAT CIVILE

- ❑ Krahës kanaleve të ujrave të larta janë inspektuar edhe kanale dytësore që varen nga bashkitë, ku në përgjithësi gjendja e këtyre kaneleve është e mirë për të përballuar intesitetin e reshjeve që pritet të bien gjatë dimrit.
- ❑ Ndërmarrjes së Ujitjes dhe Kullimit iu la detyrë rishikimi dhe ndërhyrja në dy kanalet e bashkisë Durrës si në atë Arapaj-Kovalishenc ashtu dhe në kanalën e ujrave të larta Spitallë për të ndërhyrë vetëm në pikat problematike të këtyre kanaleve.



GJENDJA CIVILE

❑ Në zbatim të Ligjit Nr. 10129, datë 11.05.2009” Për Gjendjen Civile” zyra e arkivit të gjendjes civile ka lëshuar çertifikata të shërbimit të gjendjes civile, duke plotësuar kërkesat e shtetasve për akte trashëgimie 220, për sigurime shoqërore dhe shëndetsore 50, për jashtë shtetit e për bashkim familjar 100, për arësye të ndryshme 30, për efekte gjyqësore 20, për dëmshpërmbim për të persekutuarit politik 10.

❑ Në mbështetje të Ligjit Nr.130/2013 janë lëshuar çertifikata për efekt korrigjimi të gabimeve materiale, për ndreqjen e të dhënave në rregjistrat e zyrave të gjendjes civile pranë njësive administrative përkatëse (20), si dhe fotokopjet e fletëve të rregjistrave përkatës. Mbi sasinë e çertifikatave të përdoruara sipas numrit të serisë janë mbajtur evidenca të sakta (350 fletë).

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA, NJESIA ADMINISTRATIVE

ÇERTIFIKATË FAMILJARE

Në bazë të Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010, vërtetohen të dhënat e mëposhtme:

Nr	Emri e mbiemri	Emri i babait	Emri i nënës	Gjinia Lidhja me K. Familjaren	Datëlindja			Gjendja Civile	Vendlindja	Shëtitësia	Numri personal
					Dita	Muaji	Viti				
1											
2											
3											
4											
5											
6											
7											
8											
9											
10											

Kjo certifikatë lëshohet për _____

Vëllim elektronik nga Drejtoria e Regjistrave të Gjendjes Civile
Duke: 2017/09/11 10:53:43 - 02/02/2018/01/15

Shënim: Ky dokument është i përdorueshëm vetëm nëse është nënshkruar nga Drejtoria e Regjistrave të Gjendjes Civile.



SEKTORI JURIDIK

Në mbështetje të ligjit 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, janë verifikuar 34 akte të Njërive të Vetëqeverisjes Vendore (Bashkia Durrës, Krujë dhe Shijak), të cilat janë konfirmuar të gjitha për bazueshmëri ligjore.

EVIDENCË PËR AKTET NORMATIVE TË ORGANEVE TË VETËQEVERISJES VENDORE Gusht 2020

Verifikimi i Ligjshmërisë së Akteve të Organeve të Vetëqeverisjes Vendore										Verifikimi në vend i ligjshmërisë së akteve		Dërguar në Gjykatë			
Nr.	Njësi të vetëqeverisjes vendore	Akte të hyra tek Prefekti		Të bazuara në ligj		Të pabazuara në ligj		Të rishqyrtuara nga Nj.Q.V						M	P
		Muj.	Prog.	Muj.	Prog	Muj.	Prog.	Muj.	Prog.		Muj.				
1	Këshilli i Qarkut Durrës	-	8	-	8										
2	Bashkia Durrës	6	82	6	82										
3	Bashkia Krujë	13	71	13	69		2								
4	Bashkia Shijak	15	86	15	86										
Shuma		34	247	34	245		2								

SEKTORI JURIDIK

- ❑ Në mbështetje të ligjit 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, janë verifikuar 42 akte të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore (Këshilli i Qarkut Durrës, Bashkia Durrës, Bashkia Krujë, Bashkia Shijak), nga të cilat:
 1. Për verifikimin e funksioneve e të përgjegjësisë të deleguara në zbatimin e akteve ligjore, buxhetimin e këtyre funksioneve dhe përgjegjësisë, respektimin e standarteve të vendosura;
 2. Për shërbimet publike që ofrojnë organet e njësive të vetëqeverisjes vendore;
 3. Për transparencën dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e hartimit të planeve dhe buxheteve vendore;
 4. Për shprehjen e ligjshmërisë të Vendimit të Këshillit Bashkiak, për vendimet e marra për kryerjen e shpronësimeve në zbatim të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes public”, i ndryshuar;
 5. Për punën dhe veprimtarinë e Prefektit të qarkut në lidhje me rritjen e performancës të zgjedhurve të njësive të vetëqeverisjes vendore. Kjo në mabshkëpunim me të gjitha projektet që po zbatohen në 61 Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.

SEKTORI JURIDIK

➤23 Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore:

Për shqyrtimin e kërkesave të ardhura në komisionin vendor të titujve të pronësisë;

Për numrin e vendimeve të marra

Për ndjekjen e proceseve gjyqësore;

Për problematikat e vërejtura nga komisioni vendor i titujve të pronësisë gjatë procesit të ndarjes së tokës bujqësore në nivel qarku.

➤24 Për urdhërat dhe udhëzimet e nxjerra nga prefekti i qarkut:

Për zbatimin e akteve të prefektit nga subjektet të cilëve ju drejtohet;

Për rastet e konflikteve të subjekteve.

➤25 Për veprimtarinë e organit këshillues të prefektit të qarkut:

Për shqyrtimin e tematikave dhe problematikave të trajtuara në organin këshillues të prefektit të qarkut;

Për funksionimin bazuar në rregulloren e organit këshillues.

➤26 Pasqyrë për aktet e organeve të vetqeverisjes vendore:

Për aktet e organeve të vetqeverisjes vendore të dërguara tek prefekti (1 mujore, 3 mujore dhe vjetore), e cila të përmbajë: aktet normative të paraqitura tek prefekti i qarkut, aktet normative të bazuara në ligj, aktet normative të pabazuara në ligj, aktet normative të rishqyrtuara nga organet e njësive të vetqeverisjes vendore, si dhe aktet normative të dërguara në gjykatë.

➤27 Për raportime të veçanta.

Për bashkërendimin e punës me Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve dhe struktura të tjera zgjedhore vendore, në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor.

FINANCA DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

- ❑ Gjatë Gusht 2020 nga ana e Sektorit të Financës e Shërbimeve Mbështetëse, në zbatim të planit të punës të hartuar më parë, janë realizuar detyrat si më poshtë:
- ❑ Është kryer në afat hartimi i listpagesave Korrik 2020, përlllogaritja e kontributeve dhe tatimit, përpilimi i urdhër shpenzimeve si dhe u bë ndjekja e pagesave në Thesar dhe Bankë.
- ❑ U krye përgatitja, rakordimi dhe raportimi i Situacionit Buxhetor për periudhën Janar-Korrik 2020 të cilat u dërguan në Ministri dhe në Thesar.
- ❑ Është realizuar përgatitja, rakordimi dhe raportimi i të Ardhurave për periudhën Janar-Korrik 2020 të cilat u dërguan në Ministri dhe në Thesar.
- ❑ U realizua Përgatitja e dokumentacionit për Projekt Buxhetit për vitin 2021 dhe PBA 2021-2023 dhe P/Buxheti i rishikuar për Prefekturën.
- ❑ U krye arkëtimi i lekëve të pullave të gjendjeve civile Durrës dhe Krujë dhe derdhja e tyre në bankë. Është realizuar mbajtja e sistemit të kontabilitetit të vlerave monetare dhe materiale, lëvizjen e aktiveve, raportim për vendimmarrjen në funksion të realizimit të objektivave, përgatitja e pasqyrave financiare të institucionit dhe depozitimi në degën e thesarit dhe Ministrinë e Brendshme.
- ❑ Është kryer menaxhimi dhe administrimi i faqes zyrtare të Prefekturës. Përpunimi dhe shpërndarja e korrespondencës si dhe nisja brenda afateve kohore të të gjithë dokumentacionit që del nga institucioni

PYETJE?



FALEMINDERIT!

